



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 99

2003

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MTT dhe MRP nr.4447, datë 23.9.2003	Për shoqërimin teknik të mjeteve jashtë norme në kryerjen e transporteve në kushte jonormale.....	4261
Rregullore e Bankës së Shqipërisë	Për licencimin e subjekteve jobanka.....	4274

UDHËZIM
Nr.4447, datë 23.9.2003

PËR SHOQËRIMIN TEKNIK TË MJETEVE JASHTË NORME NË KRYERJEN E
TRANSPORTEVE NË KUSHTE JONORMALE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.8378, datë 22.7. 1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 15 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit dhe Ministri i Rendit Publik

UDHËZOJNË:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kërkesave për shërbimin e shoqërimit teknik në procesin e kryerjes së transporteve në kushte jonormale me mjete jashtë norme.

Shoqërimi teknik kryhet nga subjekte të autorizuar për këtë shërbim ose të shoqëruara nga Policia Rrugore.

Neni 2

Transporti në kushte jonormale, me mjete jashtë norme kryhet nga subjekte (shoqëri ose ndërmarrje) që i kanë të regjistruara këto mjete në emër të subjektit, i licencuar për veprimtari transporti sipas legjislacionit në fuqi dhe i pajisur me autorizim të veçantë për qarkullim, të lëshuar nga enti pronar i rrugës, duke pasur gjithashtu në disponim dhe dokumentet e nevojshme për qarkullim nga DPSHTRr-ja (Drejtoria Rajonale), konform nenit 92 të Kodit Rrugor dhe akteve në zbatim të tij.

Neni 3

Në kushtet që duhet të plotësojë subjekti transportues i interesuar për marrjen nga organi kompetent (enti pronar i rrugës) të autorizimit të veçantë të qarkullimit, bën pjesë dhe përcaktimi (ose jo) i nevojës për shoqërimin teknik apo shoqërim nga Policia Rrugore, kur një kërkesë e tillë gjykohet e nevojshme edhe nga enti pronar i rrugës, në procesin e transportit jashtë norme në vartësi të kushteve të terrenit dhe të sigurisë së lëvizjes ku do të kryhet ky transport.

Neni 4

Shoqërimi nga Policia Rrugore parashikohet kur përmasat e mjetit ose të transportit jashtë norme, kalojnë kufijtë e vlerave të treguara në pikën 4 të nenit 15 të Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor, si dhe për rastet sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 5

Kur kushtet e trafikut janë të përshtatshme dhe procesi i transportit në itinerarin e caktuar kryhet normalisht, Policia Rrugore mund të autorizojë subjektin transportues për shoqërimin e ngarkesës me mjetet e tij.

Neni 6

Shoqërimi teknik për mjete e transporte jashtë norme, parashikohet kur verifikohet njëri nga rastet e përshkruara në pikat 3 dhe 4 të nenit 15 të Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.

KREU II
AUTORIZIMI PËR SHËRBIMIN E SHOQËRIMIT TEKNIK DHE KUSHTET
PËR LËSHIMIN E TIJ

Neni 7

Shërbimi për shoqërimin teknik, për kryerjen e transportit jashtë norme:

- mund të autorizohet të kryhet me mjetet dhe personelin e subjektit të interesuar;
- mund të autorizohet të kryhet nga ndërmarrje të specializuara të vendit apo shoqëri të huaja të legalizuara në Shqipëri, që plotësojnë kushtet e përshkruara në këtë udhëzim, si dhe që deklarojnë veçanërisht për respektimin e rregullave të qarkullimit, sinjalizimit rrugor, përdorimin e sinjalizimit pamor e ndriçues, organizimin e lëvizjes dhe drejtimit të mjeteve shoqëruese.

Neni 8

Në të dyja rastet e përmendura në nenin 7, subjektet pajisen me autorizimin për shërbimin e shoqërimin teknik, si dhe me dëshminë e aftësisë profesionale të personelit që kryejnë këtë shërbim.

- Lëshimi i autorizimit për shërbimin e shoqërimin teknik për transporte jashtë norme, bëhet nga policia rrugore e drejtorisë së policisë së qarkut, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

Organi që lëshon autorizimin mban një regjistër ku evidentohen të dhënat për subjektin dhe pajisjen e tij me autorizimin e shërbimit të shoqërimin teknik të transporteve jashtë norme.

- Lëshimi i dëshmisë së aftësisë profesionale të personelit të shërbimit për transporte jashtë norme, bëhet nga drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor të DPSHTRr-së, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

Organi që lëshon dëshminë e aftësisë profesionale mban një regjistër mbi të dhënat për personat dhe rezultatet e provimeve për pajisjen me këtë dëshmi.

Neni 9

Autorizimi i lëshohet titullarit të subjektit ose ndërmarrjes që do të kryejë shoqërimin teknik, kur paraqitet kërkesa pranë organit kompetent, i cili lëshon autorizimin 15 ditë përpara fillimit të transportit.

Nëpërmjet kërkesës, titullari i subjektit të theksojë dhe të vërtetojë nën përgjegjësinë e vet:

- llojin e lejes së veprimtarisë që disponon;
- ka aftësinë tekniko-profesionale dhe financiare;
- të jetë i siguruar dhe të ketë garancinë bankare për përgjegjësitë ndaj të tretëve, me një vlerë prej 50 mijë euro;
- deklaratën e përgjegjësisë (e nënshkruar sipas normave ligjore) për respektimin në çdo rrethanë të rregullave të sigurisë së lëvizjes gjatë procesit të transportit, në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor, si dhe plotësimin e kushteve për mjetet, drejtuesit e tyre dhe personelit të shoqërimin teknik sipas kërkesave të këtij udhëzimi;
- të paraqesë dëshmi penaliteti për titullarin;
- të ketë të paktën dy mjete në pronësi ose të marra me qira, të vërtetuara me dokumentet përkatëse, të cilat duhet të jenë të pajisura sipas nenit 24 të kreut IV të këtij udhëzimi;
- të paraqesë fotokopje të lejes së qarkullimit, certifikatës teknike dhe lejes së drejtimit të mjeteve.

Drejtimesit e mjeteve të shoqërimin teknik duhet të kenë detyrimisht leje drejtimi të kategorisë “B” e lart.

Neni 10

Autorizimi ka vlefshmëri 3 vjet dhe mund të rinovohet kundrejt kërkesës dhe plotësimit të

kushteve të përshkruara në nenin 14 të këtij udhëzimi.

Modeli i autorizimit i bashkëngjitet këtij udhëzimi. Ai përmban treguesit teknikë të mjeteve, të dhënat mbi aftësimin profesional të personelit etj.

Neni 11

Autorizimi mbahet vazhdimisht gjatë kryerjes së shoqërimit teknik në procesin e transportit jashtë norme, nga drejtuesit e mjeteve të shoqërimit teknik. Korrigjime apo ndërhyrje të tjera në autorizim nuk lejohen dhe e bëjnë atë të pavlefshëm.

Neni 12

Gjatë periudhës 3-vjeçare të vlefshmërisë së autorizimit, çdo ndryshim që përmban autorizimi mbi mjetet dhe personelin, duhet t'i komunikohet organit që e ka lëshuar atë, për të bërë ndryshimet përkatëse dhe për ta rinovuar atë.

Neni 13

Autorizimi mund të pezullohet për një periudhë deri në 6 muaj sipas gjykimit të organit që e ka lëshuar, kur nga organet e kontrollit të Policisë Rrugore, të Inspektoratit të DPSHTRr-së, të DPRr-së, konstatohen mosrespektim i kushteve për kryerjen e shërbimit të shoqërimit, për të cilin ai është lëshuar.

Nëse shkeljet përsëriten, atëherë autorizimi i hiqet subjektit dhe mund të lëshohet autorizim i ri vetëm pas periudhës 3-vjeçare, në funksion të plotësimit të kushteve të këtij udhëzimi.

Neni 14

Rinovimi i autorizimit

a) Autorizimet janë të rinovueshme, kundrejt kërkesës së subjektit, mbas përfundimit të periudhës 3-vjeçare të vlefshmërisë së autorizimit të mëparshëm.

Kërkesa për rinovimin e autorizimit duhet të shoqërohet me :

- një kopje të autorizimit të mëparshëm;
- një deklaratë e mbajtësit të autorizimit, ku të deklarohet se qëndrojnë të pandryshuara të gjitha kërkesat për të cilat është lëshuar ky autorizim;
- fotokopje të lejes së qarkullimit, certifikatës teknike, lejeve të drejtimit dhe dëshmive të aftësimin profesional.

b) Me rinovimin e autorizimit, organi që e lëshon atë, në bashkërendim me entin pronar të rrugës, ka të drejtën të shtojë ose të përshtasë kushte teknike të përmbajtura në autorizimin e mëparshëm.

c) Në çdo rast kushtet teknike të autorizimit, gjatë kalimit, u nënshtrohen plotësisht detyrimeve dhe kufizimeve vendore të vendosura nëpërmjet sinjalizimit ose urdhëresave vendore sipas legjislacionit në fuqi.

KREU III

MBI AFTËSIMIN PROFESIONAL TË PERSONELIT QË KRYEN SHËRBIMIN E SHOQËRIMIT TEKNIK

Neni 15

Kualifikimi i personelit me njohuritë e nevojshme për t'u aftësuar në kryerjen e shërbimit të shoqërimit teknik, si dhe pajisja me dëshminë e aftësisë profesionale të tyre, bëhet nga drejtoritë

rajonale të shërbimeve të transportit rrugor të DPSHTRr-së.

Neni 16

Për kualifikimin e personelit shërben programi i hartuar nga Policia Rrugore, DPRr-ja dhe DPSHTRr-ja.

Ky program përmban emërtesën e temave, kohën për zhvillimin e tyre dhe miratohet nga Drejtoria Qendrore e Policisë Rrugore në Ministrinë e Rendit Publik.

Mbi bazën e këtij programi, drejtoritë rajonale të DPSHTRr-së organizojnë kualifikimin e personelit, në bashkëpunim me specialistë të organeve të lartpërmendura.

Neni 17

Dëshmia e aftësisë profesionale jepet përkundrejt kalimit të një testi pyetjesh të hartuara nga komisioni i specialistëve të Policisë Rrugore, DPRr-së dhe DPSHTRr-së, i cili bën dhe vlerësimin e rezultateve të provimit.

Neni 18

Provimi konsiston në një testim me shkrim dhe bashkëbisedim gojor për pyetje sipas programit të kualifikimit dhe që kryesisht kanë të bëjnë me:

- kërkesat specifike për trafikun gjatë procesit të transporteve jashtë norme me mjete jashtë norme;
- veprimet që kryhen nga personeli i shoqërimit në situata të veçanta rrugore dhe ndërhyrjet teknike;
- destinacionin dhe mënyrat e përdorimit të pajisjeve dhe atrecaturës, që nevojitet gjatë kryerjes së këtij transporti;
- mënyrën e drejtimit të mjeteve të shoqërimit;
- kushtet teknike për përdorimin e sistemeve të sinjalizimit pamor e ndriçues.

Neni 19

Mbas përfundimit të provimit me rezultat pozitiv, organi përkatës lëshon dëshminë e aftësisë profesionale të konfirmuar nga anëtarët e komisionit, me afat vlefshmërie 3-vjeçare, pas përfundimit të së cilës dëshmia duhet të rinovohet.

Në këtë rast vlerësimi bëhet nga komisioni, mbi bazën e provimit gojor, kryesisht për specifika në ndërhyrjet teknike dhe modalitetet e shërbimit të shoqërimit teknik.

Modeli i dëshmisë së aftësisë profesionale i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

Neni 20

Në qoftë se provimi i kandidatit vlerësohet me rezultat negativ, atëherë ai mund të përsëritet deri në 3 herë brenda një periudhe 3-mujore, sipas përcaktimit të organit kompetent që lëshon dëshminë e aftësisë profesionale.

Neni 21

Shpenzimet për lëshimin e autorizimit dhe dëshmisë së aftësisë profesionale janë në ngarkim të kërkuarit të autorizimit. Tarifat miratohen nga organi kompetent sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV

AUTOMJETE TË SHOQËRIMIT TEKNIK DHE PAJISJET SHITESË TË TYRE

Neni 22

Ndërmarrja e autorizuar për kryerjen e shoqërimit teknik të mjeteve dhe transporteve jashtë norme e realizon këtë shërbim me mjetet e saj, të regjistruara dhe të pajisura me dokumentet për qarkullim, respektivisht sipas neneve 92 dhe 178 të Kodit Rrugor.

Neni 23

Automjetet e shoqërimit teknik duhet të jenë në gjendje të rregullt teknike, të pajisura me certifikatën e kontrollit teknik nga qendrat e kontrollit teknik të DPSHTRr-së, për të garantuar shërbimin normal gjatë gjithë kryerjes së procesit të transportit dhe që lejojnë instalimin e pajisjeve shtesë, që përdoren në këtë proces.

Si automjete të tilla mund të jenë tipat e përmendur në nenin 54 pika 1 germa "c", "d", "f", "g", si dhe rimorkio për transporte të veçanta ose përdorim të veçantë.

Neni 24

Sistemet dhe pajisjet shtesë që bëjnë pjesë në inventarin e mjeteve të shoqërimit teknik janë:

a) Sistem suplementar i sinjalizimit pamor me dy fenerë me dritë të verdhë vezulluese, të vendosura në mënyrë të smontueshme mbi kabinën e automjetit në pozicion të tillë që të garantojë këndet e fushëpamjes së tij. Ky sistem duhet të funksionojë pavarësisht nga funksionimi ose jo i sistemit pamor e ndriçues të vetë mjetit. (fig.L dhe M në aneksin 1 bashkëngjitur).

b) Një panel drejtkëndor, reflektues në të dyja faqet me ngjyrë të verdhë, në të cilat shkruhet me germa kapitale me ngjyrë të zezë "TRANSPORT I VEÇANTË" me përmasa të panelit 60x15 cm dhe 120x25 cm.(fig. G në aneksin 1). Paneli duhet të jetë i vendosur në pjesën më të lartë të mjetit, i dukshëm në të dyja faqet e tij dhe që nuk pengon pamjen e fenerëve të sinjalizimit shtesë pamor e ndriçues.

c) Sinjal rreziku i lëvizshëm i përdorshëm sipas kushteve të nenit 160 të Kodit rrugor, i përbërë nga trekëndësh barabrinjës 40 cm, i pajisur me mbajtëse që lejon mbështetjen mbi sipërfaqen e rrugës me pozicion vertikal, duke garantuar pamjen e tij në distancat sipas nenit 333 të Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor. (fig. N aneksi 1 bashkëngjitur)

d) Flamur me ngjyrë të kuqe, për ta vendosur në anën e majtë të mjetit shoqërues.

e) Një aparat radiotransmetues në çdo mjet shoqërimi ose mjet të transportit jashtë norme, për të garantuar komunikimin e nevojshëm midis tyre.

Neni 25

Me sistemet dhe pajisjet shtesë janë të kompletuara dhe funksionale edhe mjetet e shoqërimit teknik që lëvizin në fund të karvanit të mjeteve që kryejnë transportin jashtë norme.

Sistemet dhe pajisjet shtesë, të përshkruara në nenin 24 të këtij udhëzimi, mund të jenë të fiksuara në strukturën e mjetit ose të smontueshme.

Nëse automjetet e shoqërimit teknik nuk kryejnë këtë natyrë shërbimi, atëherë sistemet shtesë të sinjalizimit pamor–ndriçues hiqen nga funksionimi, ndërsa panelet hiqen ose u mbulohen mbishkrimet.

Neni 26

Për mjetin e shoqërimit teknik, të vendosur në fund të karvanit të mjeteve të transportit jashtë norme, në vend të panelit për të cilin bën fjalë neni 24 germa "b", mund të instalohet në pjesën e pasme të mjetit një tabelë e përbërë nga një panel me mbishkrimin me gërma të zeza "TRANSPORT I VEÇANTË" në fushë të verdhë reflektuese dhe nga sinjali "kalim i detyruar për mjete të punës në rrugë" i realizuar me shirit reflektues i klasit 2 dhe me dy drita të verdha vezulluese. Dimensionet e tabelës janë 130x90 cm. Ajo është vendosur në mënyrë të smontueshme, me qëllim që të hiqet lehtësisht nga mjeti, kur ky nuk përdoret në shërbimin e shoqërimit teknik (fig.A aneksi 1).

KREU V
RREGULLAT E KRYERJES SË SHËRBIMIT TË SHOQËRIMIT TEKNIK

Neni 27

Numri i mjeteve që marrin pjesë në shoqërimin teknik

1. Çdo mjet jashtë norme dhe që kryen transport në kushte jonormale, duhet të jetë i shoqëruar nga:

a) Një automjet i pajisur dhe që plotëson kushtet, sipas kërkesave të kreut IV të këtij udhëzimi, i drejtuar nga një person i pajisur me dëshminë e aftësisë profesionale për shoqërim teknik dhe kur:

- mjetet dhe transportet jashtë norme kanë një gjerësi jo më të madhe se 3 m e gjatësi deri 27 m, që qarkullojnë në rrugë me sens unik të lëvizjes ose me karexhata të ndara me të paktën dy korsi për çdo anë të saj;

- për qarkullim në autostradë për mjete e transporte jashtë norme që kanë gjerësi jo më të madhe se 3,2 m dhe gjatësi jo më të madhe se 18,75 m.

b) Dy automjete që plotësojnë kushtet, sipas kërkesave të kreut IV të këtij udhëzimi, me një person në drejtim (në bord), përveç drejtuesit të mjetit, pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale.

- për mjete e transporte jashtë norme që i kalojnë dimensionet e përshkruara në pikën 1 germë "a" të këtij neni e që qarkullojnë në rrugë si në germën "a".

c) Një automjet i pajisur sipas kërkesave të kreut IV të këtij udhëzimi, me një person në drejtim (në bord) përveç drejtuesit të mjetit, që ka dëshminë e aftësisë profesionale dhe kur:

- mjetet dhe transportet jashtë norme kanë gjerësi jo më të madhe se 2,55 m dhe gjatësi jo më të madhe se 27 m ose në alternativën me gjerësi jo më të madhe se 2,70 m dhe gjatësi jo më të madhe se 21 m.

- që qarkullojnë në rrugë me karexhata unike, me një ose më shumë korsi për sens lëvizje dhe në rrugët si në germën "a" të pikës 1 të këtij neni, në mënyrë të limituar për pjesët e rrugës përkohësisht me sens të dyfishtë qarkullimi.

d) Dy automjete që janë të pajisura dhe plotësojnë kushtet, sipas kërkesave të kreut IV të këtij udhëzimi, si dhe të germave "a", "b", "c" të këtij neni.

- për mjetet dhe transportet jashtë norme që i kalojnë dimensionet e dhëna në germën "c" dhe që qarkullojnë në rrugë siç përcaktohen po në germën "c".

2. Në automjetin e shërbimit të shoqërimin teknik që udhëheq në pozicionin e përparmë mjetet dhe transportin jashtë norme duhet, që bashkë me drejtuesin e mjetit, të jetë dhe një person tjetër i pajisur me dëshminë e aftësisë profesionale, ndërsa në automjetin fundor të shoqërimin teknik mund të mos ketë person shoqërues, por drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pajisur me dëshminë e aftësisë profesionale.

3. Për rastet kur mjetet dhe transportet jashtë norme kanë karakteristika ose dimensione të veçanta, nga ato të përshkruara më sipër apo për raste kur mjetet dhe transportet jashtë norme do të lëvizin në kushte të veçanta të trafikut e terrenit, atëherë shoqërimi teknik mund të kryhet më me shumë mjete të pajisura me atrecaturën dhe personelin e nevojshëm për kryerjen e shërbimit të shoqërimin teknik, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

Neni 28

Pozicioni i mjeteve në shërbimin e shoqërimin teknik

1. Mjetet e shoqërimin teknik, gjatë kryerjes së këtij shërbimi, duhet të jenë të vendosura gjithmonë në pozicion të tillë në mënyrë që gjatë procesit të transportit të garantojnë :

a) maksimumin e pamjes së karvanit, në të gjitha situatat e trafikut;

b) numrin e ndalesave eventuale për lëvizjen e sigurt të mjetit, si dhe kryerjen e ndalimit eventuale në kushte të sigurisë absolute.

2. Për kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për rrugë të tipeve të ndryshme dhe në funksion të shpejtësisë mesatare të lëvizjes së mjeteve, automjetet e shërbimit të shoqërimin teknik duhet të jenë të vendosura në pozicionet si më poshtë :

a) për rrugët ose pjesë rruge me karexhatë unike, me dopio sens lëvizje në rastet:

- kur mjetin dhe transportin jashtë norme e shoqëron vetëm një mjet i shërbimit të shoqërimin teknik, ky i fundit duhet të udhëheqë këtë transport në një distancë jo më shumë se 50 m;

- kur janë parashikuar dy automjete për shërbimin e shoqërimit teknik, automjeti i parë udhëheq transportin duke qenë në distancë jo më pak se 50 m, kurse mjeti i dytë qëndron pas mjetit të transportit jashtë norme në distancë jo më pak se 50 m dhe jo më shumë se 80 m.

b) për rrugët ose pjesë të rrugëve me sens unik ose me karexhata të ndara në rastet:

- kur është parashikuar një automjet për shërbimin e shoqërimit teknik, atëherë ky e ndjek mjetin dhe transportin jashtë norme në një distancë jo më pak se 30 m dhe jo më shumë se 150 m;

- kur janë parashikuar dy automjete për shërbimin e shoqërimit teknik, atëherë mjeti i parë ndjek transportin jashtë norme ose karvanin e veçantë në një distancë jo më të vogël se 30 m dhe jo më të madhe se 50 m, ndërsa mjeti i dytë i vendosur në fund të karvanit në distancë jo më të vogël se 100 m dhe jo më shumë se 150 m.

Neni 29

Përdorimi i pajisjeve sinjalizuese pamore

1. Gjatë kryerjes së shërbimit automjetet e shoqërimit teknik duhet të mbajnë ndezur dritat e përparme, si dhe sinjalet e tjera pamore të ndriçimit edhe kur nuk është i përcaktuar përdorimi i tyre sipas dispozitave të Kodit Rrugor.

2. Gjatë shërbimit mbahen gjithmonë në funksionim dhe pajisjet shtesë të sinjalizimit pamor për të cilat bën fjalë neni 24 i këtij udhëzimi.

KREU VI

DETYRIMET E PERSONELIT TË SHËRBIMIT TË SHOQËRIMIT TEKNIK

Neni 30

Drejtuesi i personelit të shoqërimit teknik

1. Shërbimi i shoqërimit teknik kryhet nën përgjegjësinë e drejtuesit të personelit të shoqërimit teknik, i caktuar nga subjekti i autorizuar për këtë shërbim.

2. Drejtuesi i personelit të shërbimit për shoqërimin teknik, si dhe personeli në përbërje të këtij shërbimi, duhet të jenë të pajisur me dëshminë e aftësimit personal.

Gjithashtu drejtuesi i shërbimit mban një kopje të autorizimit të subjektit për shoqërimin teknik, si dhe dokumentin e lëshuar po nga subjekti i autorizuar me anë të të cilit vërtetohet detyra e ngarkuar si drejtues i personelit të shoqërimit teknik.

Neni 31

Detyrat e drejtuesit të personelit të shoqërimit teknik

1. Detyra kryesore e drejtuesit të shoqërimit teknik konsiston në komunikimin e vazhdueshëm me drejtuesit e mjeteve të transportit jashtë norme dhe me drejtuesit e mjeteve të shoqërimit, si dhe me personelin në përbërje të shërbimit të shoqërimit, duke ndërhyrë në mënyrë sa më efektive në përballimin e çdo situatë rreziku, nëpërmjet aktivizimit të sistemeve të sinjalizimit në shërbim të kryerjes normal të transportit në kushte jonormale dhe me mjete jashtë norme.

2. Drejtuesi i shoqërimit teknik para fillimit të shërbimit të shoqërimit teknik duhet të verifikojë:

a) Pajisjen e mjeteve të shoqërimit teknik, sipas përshkrimit në nenet 24 dhe 31 të këtij udhëzimi, të instaluar në mënyrë korrekte, duke garantuar funksionimin normal të tyre.

b) Dimensionet, masat dhe karakteristikat e mjeteve të transportit jashtë norme, duke i ballafaquar ato me të dhënat sipas autorizimit të veçantë të qarkullimit me të cilat janë pajisur këto mjete, si dhe të dokumenteve të tjera të qarkullimit (lejeqarkullimi, certifikatë teknike).

c) Funksionimin e plotë të pajisjeve të sistemit të ndriçimit e sinjalizimit pamor, po ashtu pajisjet shtesë të sistemit të sinjalizimit ndriçues e pamor, panelet drejtkëndore reflektuese, gjenden e gomave brenda kushteve teknike të lejuara etj.

d) Autorizimet e veçanta të qarkullimit të jenë të sakta, pa korrigjime dhe brenda afateve të vlefshmërisë së tyre.

e) Mjetet të kenë kryer kontrollin teknik në afatin e duhur, vërtetuar nga certifikata e kontrollit

teknik, lëshuar nga DPSHTRr-ja.

f) Lejet e drejtimit të drejtuesve të mjeteve të transportit jashtë norme, të cilat nuk duhet të jenë më pak se të klasës “C” dhe “CE”.

3. Në rastet kur gjatë procesit të transportit, mjeti i transportit jashtë norme ndalet për arsye defekti, nuk plotësohen kushtet e sigurisë apo nuk respektohen kërkesat sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, atëherë shërbimi i shoqërimit teknik ndërpret udhëtimin, dhe mjeti jashtë norme, që po kryen transportin jashtë norme, dërgohet në vendin më të afërt të përshtatshëm për qëndrim, duke marrë masa për sigurinë e qarkullimit rrugor gjatë lëvizjes së këtij mjeti.

4. Drejtuesi i personelit të shoqërimit teknik, përveç respektimit të kërkesave të pikës 2 të këtij neni është përgjegjës për kryerjen normalisht dhe përmeshjen e kushteve që lidhen me itinerarin e transportit jashtë norme dhe të modaliteteve të ecjes e të qëndrimit, sipas përcaktimeve të bëra në autorizimin e veçantë të qarkullimit, si dhe në autorizimin e shërbimit të qarkullimit të Policisë Rrugore apo organit kompetent që e lëshon atë.

Neni 32

Kompleti i pajisjeve për përdorim nga personeli i shërbimit të shoqërimit teknik

1. Në kompletin e pajisjeve të personelit për kryerjen e shërbimit të shoqërimit teknik përfshihen:

- a) një telefon radiomobil për komunikime emergjente;
- b) një flamur ngjyrë portokalli fluoreshent për sinjalizime të ndryshme;
- c) dy tabela dore (ngjyrë të kuqe e të gjelbër) për rregullim qarkullimi në mënyrë të alternuar (fig. D aneksi 1);
- d) pesëmbëdhjetë kone prej gome ose plastike, ngjyrë të kuqe me unaza ngjyrë të bardhë, të pajisura me shirit reflektues kl.2, me lartësi 50 cm (fig. B aneksi 1);
- e) xhupa ose jelekë me element fosforeshent për personelin e shërbimit, për t'a bërë të dukshëm në distancë, veçanërisht në kushtet e pamjes së kufizuar;
- f) një pajisje për matje lartësie dhe gjatësie, për t'i përdorur për verifikim të dimensioneve të mjetit të transportit jashtë norme, përmasave të ngarkesave dhe të pjesëve të rrugës me probleme.

Neni 33

Rregullat e kryerjes së shërbimit të shoqërimit teknik

1. Në rastet kur, për shkak të ngadalësimit apo shpejtësisë së kufizuar të lëvizjes së mjeteve të transportit jashtë norme, verifikohet një vargëzim i mjeteve, atëherë karvani duhet të hapë krahun dhe të qëndrojë, nëse është e mundur, jashtë karexhates për të bërë të mundur kalimin e mjeteve që kanë mbetur.

2. Në raste kur mjeti i transportit jashtë norme mbetet i bllokuar për shkak defektesh, aksidenti apo për shkaqe të tjera, në karexhate ose bankine, duhet që menjëherë të aplikohen masat e duhura për një sinjalizim efikas dhe një mbrojtje të përshtatshme, duke përdorur pajisjet që ka mjeti i shoqërimit teknik.

Distancat ndërmjet elementeve përbërës të sistemit të sinjalizimit dhe të mbrojtjes mund të variojnë në vartësi të tipit të rrugës, kushteve të lartësisë dhe ato ambientale të pamjes.

3. Në raste të dëborës, ngricave, pamjes së kufizuar për shkak të mjegullës ose për shkaqe të tjera, kur nuk është e mundur të shihet një pjesë rruge prej 70 m, atëherë mjeti i transportit në kushte jonormale ose jashtë norme, duhet që menjëherë të largohet nga karexhata dhe të drejtohet në një zonë të përshtatshme qëndrimi, ku nuk ka rreziqe për qarkullimin e mjeteve dhe ku, nëse është e nevojshme ose mund të tregohet prezenca e karvanit me sinjalitikën përkatëse.

KREU VII TË NDRYSHME

Neni 34

Panelet mbrapa reflektues

1. Mjetet jashtë norme dhe transportet jashtë norme, ku përfshihen dhe mjetet e ngarkim-transportit, duhet të jenë të pajisura me panele mbraparefleksive fluoreshente, për sinjalizimin gjatë

kryerjes së procesit të transportit të daljes gjatësore a tërthore të ngarkesave jashtë gabariteve të mjetit, për përdoruesit e tjerë të rrugës, siç përcaktohet në nenin 162 të Kodit Rrugor.

2. Panelet mbraparefleksive prodhohen kryesisht nga fletë alumini, lllamarinë çeliku apo PVC mbi të cilën vendoset materiali fluoreshent i përthyeshem, kl 2, për formimin e shiritave sipas rasteve, me ngjyre të bardhë, të kuqe, të verdhë ose të zezë.

Kur në një mjet vendosen dy panele, shiritat e tyre janë në pozicion të alternuar në kënd 45°.

3. Panelet mbraparefleksive për mjetin jashtë norme ose për mjete që përdoren për transporte në kushte jonormale, përfshirë dhe mjetet e ngarkim-transportit, si dhe panelet që sinjalizojnë daljet e ngarkesave, jepen në aneksin 2 bashkëngjitur, duke qenë të përcaktuara, përmasat, ngjyrat dhe karakteristika të tjera, sipas kërkesës së nenit 10 pika 6 e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.

4. Destinacioni i përdorimit të paneleve mbraparefleksive, të paraqitura në aneksin 2, referuar çdo figure, është:

a) fig.1 – Për automjete të rënda (kamion, tërheqës) të kategorisë N3 (mjete për transport mallrash me peshë max. me ngarkesë >10 ton. Shiritat të pjerrët të alternuar, prej materiali fluoreshent të kuqe dhe prej materiali të verdhë reflektues.

b) fig. 2 – Për mjete të gjata, kryesisht rimorkio dhe gjysmërimorkio të kategorisë O3 me gjatësi >8m dhe për të gjitha rimorkiot e kategorisë O4, me peshë max. me gjithë ngarkesë >10 ton. Korniza fluoreshente e kuqe, fusha e verdhë reflektuese.

c) fig. 3 – Për sinjalizimin e daljes gjatësore të ngarkesave, jashtë mjetit. Vendosen 1-2 copë në vartësi të gjerësisë që zë ngarkesa, në fund të ngarkesës në vend të dukshëm.

d) fig. 4 – Për sinjalizimin e daljes anësore të ngarkesave nga mjeti. Vendosen 2 copë në të dy krahët majtas/djathtas.

e) fig. 5 dhe fig. 6 – Për sinjalizimin e mjeteve që mbarten dhe transportohen me automjete që kanë karrocieri për përdorim të veçantë të destinuar për këtë qëllim.

f) fig. 7 dhe fig 7a – Për sinjalizimin e pengesave skajore ose daljeve të rrezikshme.

Neni 35


Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE I
TELEKOMUNIKACIONIT
Spartak Poçi


MINISTRI I RENDIT PUBLIK
Luan Rama

Aneksi 1


PAJISJET E MJETEVE DHE PERSONELIT TË SHOQËRIMIT TEKNIK SIPAS NENEVE 25, 27
DHE 33




Neni 25 germa a




Neni 25 germa c




Neni 25 germa c , Neni 27
a = 60-120 cm
b = 15-25 cm



Neni 27
a = 130 cm
b = 90 cm



Neni 33 pika 1 germa d
a = 18 cm
h = 50 cm



Neni 33 pika 1 germa c
a = 30 cm
b = 20 cm

PANELE MBRAPAREFLEKTUESE-FLUORESHENTE QË PËRDOREN PËR SINJALIZIMIN E
TRANSPORTEVE JONORMALE DHE MJETEVE JASHTË NORME




Fig. 1
2 cope 56,5 x 14 cm




Fig. 2
2 cope 56,5 x 20 cm



Fig. 3
50 x 50 cm




Fig. 4
2 cope 60 x 30 cm




Fig. 5
2 cope 56,4 x 28,2 cm



Fig. 6
42,3 x 42,3 cm




Fig. 7
2 cope 100 x 10 cm




Fig. 7 a
2 cope 100 x 10 cm



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E RENDIT PUBLIK
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË

AUTORIZIM

PËR
SHËRBIMIN E SHOQËRIMIT TEKNIK
NË TRANSPORTE JONORMALE
ME MJETE JASHTË NORME

Nr. _____

Subjekti _____ me leje veprimtarie nr. _____ dt. _____

Titullari i subjektit _____
(emri, atësia, mbiemri) **Firma**

Autorizohet të kryejë shërbimin e shoqërimit teknik për transporte jashtë norme
të subjektit _____ me:

- Itinerari _____
- Lloji i ngarkesës _____

Shoqërimi teknik do të kryhet me mjetet dhe personelin e nevojshëm që
plotësojnë kushtet sipas neneve 19, 25, 33 të udhëzimit nr. _____ datë ____/____/____

Mjetet e shoqërimit:

Personeli shoqërues:

Numri i mjeteve _____

Numri i personave _____

Marka _____

1) _____

(emri, mbiemri)

Tipi _____

2) _____

(emri, mbiemri)

Targa _____

3) _____

(emri, mbiemri)

Nr. i lejes së qarkullimit _____

4) _____

(emri, mbiemri)

Nr. i dëshmisë së aftësisë profesionale :

1) _____ 2) _____ 3) _____ 4) _____

Organi që e lëshon _____

Nëpunësi i autorizuar: _____

(emri, mbiemri)

Firma, Vula ☐

Data e lëshimit ____/____/____ e vlefshme deri ____/____/____

Shënim:

- Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 3-vjeçare nga data e lëshimit.
- Çdo korrigjim e bën atë të pavlefshëm.
- Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

DËSHMI E AFTËSIMIT
PROFESIONAL

PËR
DREJTUESIT E MJETEVE DHE PERSONELIN
E SHËRBIMIT TË SHOQËRIMIT TEKNIK
PËR TRANSPORTE DHE MJETE JASHTË NORME

Nr. _____

Lëshuar Z. _____
(emri, atësia, mbiemri) Firma e mbajtësit

Organi që e lëshon _____

Nëpunësi i autorizuar: _____
(emri, mbiemri) Firma, Vula ☐

Data e lëshimit ____/____/____ e vlefshme deri ____/____/____

Shënim:

- Dëshmia është e vlefshme për një periudhë 3-vjeçare nga data e lëshimit.
- Çdo korrigjim e bën atë të pavlefshme.
- Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.

RREGULLORE PËR LICENCIMIN E SUBJEKTEVE JOBANKA

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1.1 Në këtë rregullore përcaktohen:

- kushtet, afatet dhe procedurat e dhënies së licencës për të ushtruar veprimtari nga subjektet jobanka,

- kushtet, afatet dhe procedurat e revokimit të licencës për ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet jobanka,

- procedurat në rast të kërkesave për shtimin e veprimtarisë nga subjektet jobanka.

1.2 Bazën ligjore të kësaj rregulloreje e përbëjnë: ligji nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë; ligji nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë " neni 1 pika 3; ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare“, si dhe të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

1.3 Banka e Shqipërisë është autoriteti licencues dhe mbikëqyrës i subjekteve jobanka, për aktivitetet për të cilat ajo i licencën.

1.4 Subjekte jobanka do të quhen të gjitha subjektet që kryejnë veprimtaritë e parashikuara në këtë rregullore. Në përputhje me licencën e marrë, subjekti jobankë ka të drejtë:

a) të japë kredi;

b) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;

c) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;

ç) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);

d) të ushtrojë qiranë financiare;

dh) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;

e) të ofrojë garanci të tjera (që cilat nuk emërtohen garanci bankare);

ë) të shërbejë si agjente ose këshilltare financiare (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikat 3/a dhe 3/b të nenit 26 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”).

1.5 Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje termat e përdorur në të kanë të njëjtin kuptim si ato të shprehura në nenin 2 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Ndërsa termat vijues të kësaj rregulloreje kanë këto domethënie:

a) “kapitali fillestar minimal”, përfaqëson shumën minimale të kapitalit të kërkuar nga Banka e Shqipërisë për t’u paguar si kontribut në para nga subjekti jobankë, për marrjen e licencës për të ushtruar veprimtaritë e pikës 1.4 të kësaj rregulloreje;

b) “kapitali fillestar i paguar”, përfaqëson kapitalin që ka paguar subjekti jobankë për të filluar veprimtarinë për të cilën licencohet.

1.6. Subjektet jobanka ndalohen të kryejnë veprimtarinë e pranimi dhe të grumbullimit të depozitave.

1.7 Subjektet e kësaj rregulloreje janë të detyruara të zbatojnë aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë, si dhe të raportojnë në bazë të këtyre kërkesave.

Neni 2

Kapitali fillestar dhe burimet e tij

2.1 Në bazë të llojit të veprimtarive që subjekti jobankë kërkon të kryejë, shuma e kapitalit fillestar minimal, të jetë si më poshtë:

a) të japë kredi	100 milionë lekë;
b) të ofrojnë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve	30 milionë lekë;

c) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave	100 milionë lekë;
ç) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat)	10 milionë lekë;
d) të ushtrojë qiranë financiare	100 milionë lekë;
dh) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit	30 milionë lekë;
e) të ofrojë garanci të tjera (të cilat nuk emërtohen garanci bankare	100 milionë lekë;
ë) të shërbejë si agjente ose këshilltare financiare (këtu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikat 3/a dhe 3/b të nenit 26 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë")	10 milionë lekë.

2.2 Pagesa e shumës së kapitalit fillestar minimal mund të bëhet në monedhën shqiptare (lekë), në dollarë amerikanë ose në monedhën europiane euro, që përbëjnë kundërvleftën e kapitalit në lekë, sipas pikës 2.1 të kësaj rregulloreje, vlerësuar me kursin mesatar ditor, të llogaritur nga Banka e Shqipërisë në ditën e pagesës së kapitalit.

2.3 Kapitali fillestar minimal për subjektet jobanka, që kërkojnë të kryejnë dy ose më shumë veprimtari, të përcaktuara në pikën 1.4, të jetë jo më i vogël se më i madhi, ndërmjet kapitaleve të kërkuara në respektim të pikës 2.1, për secilën nga veprimtaritë për të cilat subjekti jobankë kërkon të licencohet.

2.4 Pagesa e kapitalit fillestar minimal kryhet në një llogari garancie, në një nga bankat e nivelit të dytë të licencuara në Republikën e Shqipërisë dhe bllokohet deri në marrjen e licencës. Pagesa bëhet me xhirim në llogari, brenda 5 ditëve nga njoftimi i Bankës së Shqipërisë për derdhjen e kapitalit.

2.5 Ndryshimin e shumës së kapitalit fillestar minimal për licencimin e një subjekti jobankë e përcakton Banka e Shqipërisë dhe e publikon këtë në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

2.6 Burimi i kapitalit të paguar nuk mund të jetë hua, kredi apo paradhënie nga subjekte të treta.

2.7 Pagesat dhe/ose shpenzimet për blerjen ose për marrjen me qira të lokaleve të subjektit jobankë dhe të pajisjeve të punës nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal.

2.8 Kontabiliteti organizohet në mbështetje të ligjit "Për kontabilitetin" dhe në përshtatje me "Manualin e Kontabilitetit Bankar", miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 820, datë 30.12.1998 dhe në respektim të akteve rregullative, të miratuara nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim.

Neni 3

Kërkesa për marrjen e licencës

3.1 Kërkesa për marrjen e licencës për të kryer një ose disa nga veprimtaritë e pikës 1.4 të kësaj rregulloreje, bëhet me shkrim dhe paraqitet në Bankën e Shqipërisë. Në përmbajtjen e kësaj kërkesë deklarohet angazhimi për zbatimin e legjislacionit shqiptar dhe të kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë.

3.2 Kërkesa për marrjen e licencës të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë rregullore dhe me formularët bashkëlidhur. Kërkesa si më sipër të jetë e nënshkruar nga themeluesit ose personat e autorizuar prej tyre.

3.3 Dokumentacioni në gjuhën shqipe paraqitet në origjinal dhe/ose në fotokopjen e noteruar të tij. Dokumentacioni në gjuhë të huaj paraqitet në origjinal ose në fotokopjen e noteruar të tij, e vërtetuar nga autoritetet shtetërore kompetente të vendit ku është lëshuar dokumenti ose të vendit të origjinës së kërkuarit, që e kanë njohur këtë dokument. Ky dokumentacion të jetë i shoqëruar nga përkthimi në gjuhën shqipe dhe i noteruar.

Neni 4

Dokumentacioni i kërkuar

4.1 Për kapitalin dhe burimin e tij:

a) deklaratën noteriale të themeluesve, se burimi i kapitalit të paguar të subjektit jobankë nuk

është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta;

b) deklaratën noteriale të themeluesve mbi burimin e kapitalit të paguar;

c) dokumentin që vërteton pagesën e kapitalit fillestar.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë që të kërkojë, në rrugë institucionale, sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme për të dalë qartë burimi i krijimit të parave, që do të shërbejnë si kapital i subjektit jobankë.

4.2 Për themeluesit:

a) aktmarrëveshja e krijimit të shoqërisë (nëse ka të tillë);

b) vendimi i regjistrimit si person juridik në gjykatë, si dhe çdo ndryshim i tij;

c) akti i themelimit të personit juridik dhe statuti i shoqërisë;

d) lista e themeluesve dhe pjesëmarrja e tyre në kapitalin e shoqërisë;

e) struktura e organizimit dhe lista e administratorëve të shoqërisë.

Veprimtaria për të cilën kërkohet licenca duhet të jetë e përfshirë në vendimin e regjistrimit në gjykatë.

4.2.1 Kur themeluesit janë persona juridikë:

a) vendimi i regjistrimit në gjykatë, akti i themelimit dhe statuti i personit juridik dhe certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;

b) vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatim- taksave nga themeluesit për vitin e fundit financiar (për personat juridikë të huaj - në vartësi të legjislacionit përkatës të vendit të huaj, në rast të kundërt deklaratën personale);

c) deklaratë noteriale për detyrimet ndaj të tretëve dhe për shlyerje të rregullta të tyre (në qoftë se ka);

d) në rastin e pjesëmarrjes influencuese në subjektin jobankë dokumentacioni plotësohet me të dhënat për veprimtarinë tregtare për vitin e fundit, pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e fundit, të vërtetuara nga eksperti kontabël i autorizuar;

e) vendimin e organit vendimmarrës të shoqërisë për pjesëmarrjen në kapitalin e subjektit jobankë.

4.2.2 Kur themelues janë persona fizikë tregtarë ose individë:

a) për personat fizikë tregtarë: akti i regjistrimit të shoqërisë, certifikata e regjistrimit në organin tatim-taksave dhe vërtetim nga organet e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve ndaj tyre;

- për individët: emër, mbiemër, adresa, kombësia, shtetësia, edukimi, punësimi aktual dhe i shkuar dhe dëshmi penaliteti;

b) vërtetime nga gjykata dhe prokuroria se ndaj këtyre shtetasve nuk është hapur proces gjyqësor dhe nuk janë në ndjekje penale, si dhe dëshmi penaliteti lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (për shtetasit e huaj në vartësi të legjislacionit përkatës);

c) deklaratë noteriale për detyrimet ndaj të tretëve dhe për shlyerje të rregullta të tyre (në qoftë se ka);

d) lista e bizneseve në të cilat themeluesi i subjektit financiar jobankë ka pjesëmarrje influencuese, si dhe përqindja e kapitalit që disponon, akti i regjistrimit, numri në regjistrin tregtar, numri i identifikimit të personit në lidhje me pagimin e tatim-taksave, të dhëna mbi ndonjë rast falimentimi të tyre, në qoftë se ka pasur biznes.

4.3 Për administratorët:

Në Bankën e Shqipërisë paraqitet lista e administratorëve të shoqërisë.

Për secilin prej këtyre paraqiten:

a) kopje të vendimit të organeve vendimmarrëse të shoqërisë për emërimin e administratorëve;

b) CV-ja e firmosur e çdo administratori;

c) vërtetime nga gjykata dhe prokuroria se ndaj këtyre shtetasve nuk është hapur proces gjyqësor dhe nuk janë në ndjekje penale, si dhe dëshmi penaliteti lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (për shtetasit e huaj në varësi të legjislacionit përkatës).

4.4 Planbiznesi i propozuar.

Themeluesit paraqesin planin e veprimtarisë së subjektit për vitin e parë të veprimtarisë ku minimalisht të përfshihen:

a) veprimtaritë që propozon të kryejë dhe objektivat për të ardhmen;

- b) vlerësimi i tregut, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij;
- c) politika e subjektit për veprimtaritë që kërkon të kryejë, objektivat dhe pozicioni i tij në treg;
- d) struktura e organizimit të shoqërisë;
- e) parashikimi i gjendjes financiare të subjektit për vitin e parë të veprimtarisë së tij, pasqyrat financiare.

Neni 5

Verifikimi dhe afatet

5.1 Banka e Shqipërisë bën verifikimin e plotësimit të dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

5.2 Data e pranimit të kërkesës për licencë, konsiderohet data kur kërkuuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas kësaj rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim, nga Banka e Shqipërisë, kërkuuesit dhe që nga ky moment fillon llogaritja e afatit dymujor të përcaktuar për marrjen e vendimit.

5.3 Banka e Shqipërisë, brenda dy muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, miraton ose refuzon kërkesën për licencë dhe njofton me shkrim kërkuuesin për vendimin e saj.

5.4 Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë do të dërgojë një njoftim për mangësitë, për konfliktet me ligjin, si dhe kërkesa për informacion shtesë.

5.5 Mangësitë dhe vërejtjet e tjera të konstatuara në dokumentacionin e paraqitur, sipas kësaj rregulloreje, të mënjanohe brenda një muaji nga data e njoftimit të tyre. Në rast të kundërt, Banka e Shqipërisë ndërpret shqyrtimin e kërkesës dhe për këtë njofton kërkuuesin.

Neni 6

Kushtet që duhen plotësuar për marrjen e licencës

6. Subjekti jobankë që kërkon të licencohet duhet të plotësojë këto kushte:

6.1 Dokumentacioni i paraqitur të jetë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

6.2 Dokumentin që vërteton se kapitali fillestar minimal është depozituar në një llogari garancie.

6.3 Procedurat kontabile të jenë hartuar në përputhje me detyrimet e pikës 2.8 të kësaj rregulloreje.

6.4 Aktet e brendshme rregullative të jenë miratuar nga organet vendimmarrëse.

6.5 Subjektet e kësaj rregulloreje që do të kryejnë veprimtaritë e përcaktuara në pikën 1.4 me rrjet shërbimi, të paraqesin kontratat-tip, që do të lidhin me të tretët, ku shprehimisht të cilësohet se subjekti jobankë është përgjegjës për shërbimet që do të kryhen.

6.6 Për ambientet e punës të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratën e qirasë, dokumente të tjera (kontrata, vërtetime etj) të lëshuara nga organet përkatëse, ku të tregohet nëse ambientet e punës i plotësojnë kërkesat për siguri dhe mbrojtje, lehtësi komunikuese dhe sigurimin nga zjarri.

6.7 Për pajisjet e punës (kompjutera, programe, telekse, telefona, fakse etj.) të paraqitet lista e tyre. Këto pajisje të jenë të përshtatshme për veprimtarinë e subjektit dhe të instaluara.

6.8 Të paraqesë vërtetim se ka të hapur, të paktën pranë një banke të licencuar në Republikën e Shqipërisë, llogari në lekë ose në valutë.

Neni 7

Miratimi ose refuzimi i kërkesës për licencë

7.1 Departamenti i Mbikëqyrjes përgatit informacionin dhe jep opinionet lidhur me kërkesën e paraqitur, pasi:

- a) ka analizuar dokumentacionin e paraqitur duke bërë dhe verifikime;
- b) ka organizuar takime me administratorët e propozuar të subjektit jobankë për të diskutuar planbiznesin e paraqitur dhe probleme të tjera të lidhura me veprimtarinë e propozuar të subjektit etj.;
- c) ka vlerësuar aftësinë profesionale të administratorëve;
- d) ka verifikuar në vend kushtet në të cilat subjekti do të zhvillojë veprimtarinë.

7.2 Vendimi për dhënien ose për refuzimin e miratimit paraprak për licencë merret nga

administratori i Bankës së Shqipërisë, kur plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

7.3 Dhënia e licencës ose refuzimi për ta dhënë atë, së bashku me arsyet e këtij refuzimi, i bëhet e njohur me shkrim kërkuarit nga Banka e Shqipërisë brenda pesëmbëdhjetë ditëve-pune, pas marrjes së vendimit përkatës.

Neni 8 Publikimi

Dhënia e licencës, për të vepruar si subjekt jobankë, publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Neni 9 Informacion për fakte të tjera

9.1 Faktet e reja e rrethanat e konstatuara pas dhënies së licencës, si dhe ndryshimet që ato sjellin në dokumentet e paraqitura, të cilat kanë shërbyer si bazë për dhënien e licencës do t'i njoftohen me shkrim Bankës së Shqipërisë.

9.2 Njoftimi sipas paragrafit 9.1 do të bëhet brenda 15 ditëve, pas ndodhjes së faktit ose konstatimit të rrethanave përkatëse.

Neni 10 Revokimi i licencës

10.1 Licenca e subjektit jobankë revokohet me vendim të administratorit përkatës të Bankës së Shqipërisë kur:

- a) kërkohet nga vetë subjekti i licencuar;
- b) licenca është siguruar në bazë të informacionit jo të vërtetë, pavarësisht nëse është dhënë nga kërkuari ose ka të bëjë me kërkuarin, duke përfshirë të dhënat për kualifikimet, përvojën ose reputacionin e administratorëve dhe të themeluesve me pjesëmarrje influencuese të propozuar, ose parregullsi të tjera materiale të shkaktuara në lidhje me kërkesën për licencë;
- c) subjekti financiar jobankë nuk ka filluar veprimtarinë ose ka ndërprerë këtë veprimtari për më shumë se 6 muaj.
- d) zotëruesit e kuotave të subjektit jobankë kanë vendosur të shpërndajnë a të likuidojnë subjektin ose subjekti ka pushuar së ekzistuari;
- e) në zbatim të nenit 45 pika 3 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

10.2 Vendimi për revokimin e licencës i komunikohet menjëherë, me shkrim, subjektit, ku jepen dhe arsyet.

10.3 Vendimi për revokimin e licencës publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në një ose më shumë nga gazetat kryesore të vendit ose tirazh më të madh. Vendimi i revokimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

10.4 Subjekti ndalohet të angazhohet në veprimtari të përcaktuara në pikën 1.4 të kësaj rregulloreje, pas hyrjes në fuqi të vendimit të revokimit të licencës.

Neni 11 Regjistrimi në Bankën e Shqipërisë

11.1 Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë mban një regjistër për konsultim nga publiku, ku regjistrohen të gjitha licencat e dhëna sipas kësaj rregulloreje.

11.2 Në këtë regjistër regjistrohen emri, adresa e selisë, emrat e themeluesve dhe të administratorëve dhe veprimtaritë për të cilat subjekti është licencuar.

11.3 Një kopje e këtij regjistri mbahet për konsultim publik në çdo përfaqësi rajonale të Bankës së Shqipërisë.

11.4 Me revokimin e licencës bëhet dhe çregjistrimi nga regjistri i bankës ose i degës së bankës. Një listë e licencave të revokuara mbahet në një fletë të veçantë.

Neni 12 **Komisionet**

12.1 Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit, kërkuesi paguan në Bankën e Shqipërisë një komision prej 20 000 lekësh. Ky komision nuk rimburohet, pavarësisht nëse miratohet ose jo kërkesa për dhënie licence.

Neni 13 **Të tjera**

13.1 Të gjitha shoqëritë tregtare që kërkojnë të zgjerojnë veprimtarinë e tyre, duke kryer edhe një ose disa nga veprimtaritë e përshkruara në pikën 1.4 të kësaj rregulloreje, kanë të drejtë të paraqesin në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin përkatës të kërkesës për licencim.

13.2 Për shoqëritë e përcaktuara në pikën 13.1, shuma e kapitalit fillestar minimal për veprimtaritë e pikës 1.4 që subjekti parashikon të kryejë, të konsiderohet kapitali i llogaritur, sipas kërkesave të pikës 1.4 të rregullores “ Për normat e mbikëqyrjes të subjekteve jobanka”, me të dhënat e certifikuara nga eksperti kontabël i autorizuar.

13.3 Të gjitha subjektet jobanka, që kërkojnë të licencohen për veprimtari shtesë të përcaktuara në nenin 1.4, janë të detyruara të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) kërkesën për të kryer veprimtarinë ose veprimtaritë shtesë, të parashikuara në pikën 1.4;
b) pagimin e shtesës së shumës të kapitalit fillestar minimal, në qoftë se kapitali i llogaritur sipas pikës 13.2 si më sipër, nuk plotëson kërkesën për kapital për veprimtarinë që kërkon të kryejë ky subjekt;

c) plotësimin e kushteve teknike për kryerjen e veprimtarisë shtesë.

13.4 Të gjitha subjektet e licencuara që kërkojnë të kryejnë veprimtari shtesë, për plotësimin e kërkesave sipas pikës 13.3, nuk paguajnë komision.

13.5 Subjektet jobanka të licencuara, në rast të ndryshimit të ambienteve të kryerjes së veprimtarive, njoftojnë brenda 15 ditëve Bankën e Shqipërisë, e cila bën inspektimin për verifikimin e plotësimit të kushteve të përcaktuara në pikat 6.5 dhe 6.6 të kësaj rregulloreje.

Neni 14 **Dispozita përfundimtare**

14.1 Pjesë e pandarë e kësaj rregulloreje janë formularët bashkëlidhur.

14.2 Rregullorja “Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjektet jobanka në Republikën e Shqipërisë”, e miratuar me vendimin nr.26, datë 18.3.1999 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.

14.3 Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.96, datë 26.11.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Shkëlqim Cani

KËRKESË
PËR BANKËN E SHQIPËRISË LIDHUR ME AUTORITETIN PËR TË DHËNË LICENCË PËR
SUBJEKT JOBANKË

Emri i subjektit : _____
Vendndodhje e propozuar : Adresa _____, Shqipëri
(Qyteti)(Rrethi)

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me licencë për të kryer veprimtari si subjekt jobankë. Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë angazhohemi për zbatimin e ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të legjislationit shqiptar.

Kërkuesit

P.s. Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të kësaj rregulloreje dërgohen në adresën e mëposhtme:

Departamenti i Mbikëqyrjes
Banka e Shqipërisë
Sheshi “Skënderbej” Nr. 1
Tiranë, Shqipëri.

VENDIMI
I KËSHILLIT DREJTUES
PËR CAKTIMIN E KORRESPONDENTËVE

Këshilli drejtues i propozuar vërteton që, me sa dimë e besojmë, informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, këshilli drejtues i propozuar emëron dhe përcakton si korrespondentë :

(Emri) (Atësia) (Mbiemri)

Adresa: _____
(Rruga, Numri) (Qyteti) (Shteti)

(Numri i telefonit) (Numri i faksit/teleksit)

Korrespondenti i mësipërm është i autorizuar të përfaqësojë subjektin dhe të paraqitet të nënshkruajë para Bankës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e këshillit drejtues. Korrespondenti është i autorizuar të bëjë gjithçka të nevojshme, në mënyrë sa më të plotë dhe të përmbushë të gjitha synimet dhe qëllimet siç do të mund t'i bënte vetë i nënshkruari, nëse do të paraqiste dhe do të merrte personalisht gjithë korrespondencën dhe dokumentet nga Banka e Shqipërisë .

Datë _____,

(Emri mbiemri) (Nënshkrimi)

Shënim : Ky formular duhet të vërtetohet nga noteri.

FORMULARI NR.2

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

(të realizuara nga veprimtaria financiare)

KJO DUHET TË PARAQITET PËR VITIN E PARË TË AKTIVITETIT

TË ARDHURAT

TOTALI I TË ARDHURAVE

_____ Lekë ose Usd/Eur

SHPENZIMET

TOTALI I SHPENZIMEVE

_____ Lekë ose USD/EURO

TË ARDHURAT NETO PARA TAKSAVE

_____ Lekë ose USD/EURO

FORMULARI NR.3

ADMINISTRATORËT

Emri i subjektit jobankë: _____

1.Këshilli drejtues

Emri dhe adresa e anëtarit të këshillit drejtues	Detyra	Numri i kuotave që zotëron në kapital*	Përqindja ndaj totalit
TOTALI			

* Në qoftë se posedon.

CERTIFIKATË

Nëpërmjet së cilës unë vërtetoj se informacioni i paraqitur këtu, me sa di dhe besoj, është i vërtetë dhe i saktë. Ai pasqyron të gjitha pasuritë dhe detyrimet dhe nuk përmban fshehje të fakteve. Vërtetoj se informacioni i dhënë, i paraqitet vullnetarisht nga unë Bankës së Shqipërisë.

Çdo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve në këtë raport, mund të jetë shkak që Banka e Shqipërisë të refuzojë pjesëmarrjen time në kërkesë dhe në atë shkallë që kjo paraqitje e gabuar ose lënie jashtë e fakteve, pasqyron ndershmërinë dhe personalitetin tim, kjo mund të shërbejë si shkak për mohimin e krejt kërkesës.

Në qoftë se kërkohet informacion financiar shtesë ose më i detajuar, unë do ta paraqes atë siç kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

(Data)

(nënshkrimi i plotë)

Në qoftë se është i zbatueshëm:

(nënshkrimi i përgatitësit)

Nënshkruar në këtë ditë _____

të _____, 20 ____.

(Nënshkrimi i noterit publik)

Shënim: Do të plotësohet nga çdo themelues.

AUTORIZIM PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Të plotësohet secili prej të dy formularëve të autorizimit në origjinal)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë, _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firme, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose të kopjimit të tyre në zbatim të ligjeve të Shqipërisë.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë

Data (data /muaji/viti)

Nënshkrimi

Nënshkruar në praninë time

_____ data _____, 20 _____

KY DOKUMENT ËSHTË I

VLEFSHËM

PËR

6

MUAJ

(NËNSHKRIMI I NOTERIT PUBLIK)

ATIJ QË MUND T'I INTERESOJË:

Unë, _____, me këtë autorizoj dhe i kërkoj çdo personi, firme, nëpunësi, organi ligjor, shoqate, organizate ose institucioni, të cilët kanë në kontroll çdo lloj dokumenti, regjistri ose informacioni tjetër që ka të bëjë me mua, t'i paraqesë origjinalin ose kopjet e çdo lloj dokumenti, regjistri apo informacioni tjetër Bankës së Shqipërisë, Departamentit të Mbikëqyrjes apo ndonjë personi të autorizuar prej saj, për qëllime të inspektimit ose të kopjimit të tyre në zbatim të ligjeve të Shqipërisë.

Emri (shtypur ose printuar)

Adresa e plotë

Data (data/muaji/viti)

Nënshkruar në praninë time

_____ data _____, 20 _____

Nënshkrimi

KY DOKUMENT ËSHTË I

VLEFSHËM PËR 6 MUAJ (NËNSHKRIMI I

NOTERIT PUBLIK)

Shënim: Do të plotësohet nga çdo themelues.

LOKALET E SUBJEKTIT JOBANKAR DHE VENDNDODHJA E TIJ **

- 1) Kapitali i propozuar për t'u investuar në mjete fikse, tipi i zotërimit:
 - Vendet e përhershme marrë me qira.
 - Vendet e përhershme pronë vetiake.
 - Vendet e përkohshme.
- 2) Përshkrimi i lokaleve:
- 3) Lokalet e marra me qira:
 - A) Emri dhe adresa e pronarit, kostoja vjetore e qirasë së subjektit financiar jobankë.
 - B) Përshkrimi i riparimeve dhe i përmirësimeve të ndërtesës së marrë.
- 4) Lokalet në pronësi:
 - A) Emri dhe adresa e shitësit, data e përfundimit të ndërtimit, kostoja e blerjes së lokalit (objektit).
 - B) Kostoja dhe përshkrimi i riparimeve të nevojshme, riparime dhe ndryshime të ndërtesës dhe të ambientit rrethues.
- 5) Vendet e përkohshme:
 - A) Vendndodhja e ambienteve të përkohshme.
 - B) Detaje lidhur me ambientet e përkohshme, duke përfshirë përmasat e tyre, tipin e konstruksionit, lehtësitë më kryesore që do të vendosen në ndërtesë.
 - C) Në qoftë se ambientet e përkohshme do të blihen, parashikoni koston, vlerën e përafërt të rishitjes, një kopje të formularit-tip të kontratës së blerjes.
 - D) Në qoftë se ambientet e përkohshme do të merren me qira, jepni identitetin e qiramarrësit, qiranë mujore, nëse paguhet një qira minimum.
- 6) Tregoni investimin e propozuar në mobilje, në pajisje dhe një përshkrim të sendeve.

**** Siguroni sa më shumë të jetë e mundur nga ky informacion në kohën e paraqitjes së kërkesës. Pjesa tjetër e informacionit të dorëzohet në Bankën e Shqipërisë para marrjes së licencës përfundimtare.**

FORMULARI NR. 7

INFORMACION PËR THEMELUESIT E SHOQËRISË

[illegible]

PLANI I VEPRIMTARISË SË PROPOZUAR

Plani i veprimtarisë duhet të përcaktojë qëllimin, objektivat dhe filozofinë e biznesit të subjektit jobankë. Banka e Shqipërisë do të rishikojë vazhdimisht gjatë vitit të parë të veprimtarisë, planin e propozuar të veprimtarisë, që nga miratimi për të gjykuar nëse operacionet e subjektit financiar jobankë kryhen në përputhje me planin fillestar të dhënë të veprimtarisë, veçanërisht për sa i përket rritjes së aktiveve dhe detyrimeve. Çdo ndryshim i rëndësishëm i planit fillestar të paraqitur mund të bëhet shkak për revokimin e licencës. Për këtë arsye, duhet pasur kujdes për përgatitjen e planit të veprimtarisë.

Në planin e veprimtarisë:

1. Përshkruaj politikat sipas llojit dhe numrit të veprimtarive financiare që subjekti jobankë propozon të kryejë gjatë vitit të parë të veprimtarisë.
2. Përshkruaj burimet kryesore të huasë, si dhe metodat e ndryshme që subjekti jobankë do të shfrytëzojë për të dhënë hua. Tregoni deri në çfarë shkalle subjekti jobankë do të japë hua ose do të marrë pjesë në hua, jashtë zonës kryesore ku kryen shërbimet financiare.
3. Përshkruaj plotësisht llojet e shërbimeve që subjekti jobankë do të ofrojë.
4. Këshilli drejtues i propozuar duhet të shqyrtojë, të diskutojë dhe të miratojë kushtet e planit që mendohet të jetë me leverdi. Plani i biznesit mendohet të jetë një paraqitje e planeve dhe e parashikimeve të menduara prej këshillit, për të qenë të arritshme dhe Banka e Shqipërisë mund të mbështetet në të gjatë shqyrtimit për miratimin ose jo të kërkesës.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 8.12.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë